

K O N T R A T E

E SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

**"KORSEL" SHPK**
EMERTIME, OBJEKTI I VEPRIMTARISE, SELIA E SHOQERISE
KORCËZATJA

Ne baze te ligjit 7638, date 19.11.1992 Per shoqerite tregtare, si dhe ligjit 7667, date 28.01.1993 Per regjistrin tregtar me vullnetin e tyre te lire te shprehur ne nenshkrimin e kesaj kontrate ortaket :

1. Maksi Fejzulla, i biri i Mysenit, dtl. 20.02.1955, lindur e banues ne Korce, lagja nr.14, rruga Partizani
2. Ioanit Kumiotit, i biri i Jorgjit, banues ne Selanik rruga Filipupollos 72 te lagjes Ambellokipu

Deklarojne se kane lidhur si me poshte vijon kontraten e themelimit te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar te emertuar "KORSEL" shpk


OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Objekti i veprimtarise ekonomike te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "KORSEL" shpk eshte :

- Ne fushen e ndertimit te objekteve civile dhe industriale turistike, bujqesore, ndertim rruges, ndertim vepra arti te vogla ndertim ujesjellesish e kanalizime, rruge, punime mbrojtje dhe sistemi hidraulik, rikonstruksione godina civile e ekonomike, veshje fasadash etj. mirembajtje e zhvillim dekorit per mjedise urbane si dhe cdo gje tjeter qe lidhet me ndertimin sipas licenses perkatese.

SELIA E SHOQERISE

- Selia e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "KORSEL" shpk eshte ne Korce, lagjja nr.14, rruga "Partizani". Ajo gezon te drejten te krijojte ose te mbylle ne Shqiperi apo jashte vendit filiale, perfaqesi apo seli te tjera.



JETEGJATESIA E SHOQERISE

Jetegjatesia e shoqerise "KORSEL" shpk eshte mbi 10 vjet. Palet kane te drejte qe me vendim te asamblese se ortakeve kohezgjatja mund te nderpritet para afatit ose te kerkkojne rizgjatjen e saj prane Regjistrir Tregtar Tirane.

KAPITALI I SHOQERISE

Kapitali themeltar i shoqerise "KORSE" shpk eshte 100.000 leke, kuotat e te cilit jane te ndara ne kete menyre :

1. Maksi Fejzulla zoteron _____ % te kuotave te kapitalit fillestar.
2. Ioanit Kumiotit zoteron _____ % te kuotave te kapitalit fillestar.

Kapitali shoqeror mbyllet me 31 dhjetor te cdo viti dhe bilane duhet aprovuar brenda 4 muajve te ardhshem.

Shoqeria e fillon aktivitetin e saj ne momentin e regjistrimit ne Regjistrin tregtar prane Gjykates se Rrethit Tirane.

ORGANET E SHOQERISE

Organet e shoqerise jane :

- Asambleja e ortakeve;
- Keshilli Administrativ;
- Komisioni i revizionimit

Asambleja e ortakeve eshte organi me i larte i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "KORSEL " shpk. Administrator z. Maks Fejzulla.

Te drejtat e paleve ne kete kontrate jane si vijon :

- Te marrin pjese ne administrimin dhe drejtimin e shoqerise
- Te marrin pjese ne ndarjen e fitimit sipas kuotave respektive dhe ne perputhje me statutin.*

- Ne baze te kuotave qe kane te marrin pjese ne shperndarjen e aktivitet qe do te rezultojne mbas daljes se bilancit te likuidimit, ne rast se mbyllet shoqeria.

Te gjitha mosmarreshet qe mund te rrjedhin nga kjo kontrate ne rast se nuk mund te zgjidhen me vullnet te mire, do te zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Tirane.

O R T A K E T

MAKS FEJZULLA

IOANIT KUMIOTIT

STATUTI

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

"KORSEL" shpk

EMERTIMI, OBJEKTI I VEPRIMTARISE, SELIA E SHOQERISE

KONEZGJATJA

neni 1

EMERTIMI

Ne baze te ligjit 7638, date 19.11.1992 Per shoqerite tregtare si dhe ligjit 7667, date 28.01.1993 Per regjistrin tregtar e formalitetet qe duhen plotesuar ne te, me vullnetin e tyre te lire te shprehur ne nenshkrimin e kontrates qe i bashkohet ketij statuti, ortaket ;

1. Maksi Fejzulla, i biri i Hysenit, dtl. 1955, lindur e banues ne Korce, lagja 147 rruga Partizani

2. Ioanit Kumiotit, i biri i Jorgjit, banues ne Selanit, rruga Filipupollos, 72^W te lagjes Ambellokipu deklarojne se kane lidhur si me poshte vijon statutin e nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar "KORSEL" shpk.

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "KORSEL" shpk fiton personalitetin juridik nga dita e regjistrimit te saj ne Gjykatën e Rrethit Tirane. Ajo eshte person juridik; shqiptar dhe e zhvillon aktivitetin e saj ne perputhje me normat e legjislacionit shqiptar ne fuqi dhe ato te akteve te saj themeluese, si ky ~~u~~ statut dhe kontrata qe i bashkohet dhe qe perben nje pjese te pandare te saj.

Neni 2

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Objekti i veprimtarise ekonomike te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "KORSEL" shpk eshte :

- Ne fushen e ndertimit te objekteve e civile dhe industriale turistike, bujqesore, ndertim rruges, ndertim vepra arti te vogla; ndertim ujeshjellesish e kanalizime, punime mbrojtje dhe sistemi hidraulik, rikonstruksione godina civile e ekonomike, veshje fasadash mirembajtje e zhvillim dekorit per mjedise urbane si dhe cdo gje tjeter qe lidhet me ndertimin sipas licenses perkatese.

Fejzu

[Signature]

Aktiviteti i shoqërisë shtrihet në të gjithë territorin e Shqipërisë dhe jashtë saj. Qendra e cdo ortakut është e regjistruar në librin e shoqërisë "KORSEL" shpk.

Neni 3

SELIA E SHOQËRISË

-- Selia e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "KORSEL" shpk është në Korce, lagjja 14, rruga Partizani. Transferimi i mundshëm i selisë së shoqërisë duhet të vendoset nga Asambleja e ortakëve të shoqërisë. Ajo gëzon të drejtën me vendim të Asamblesë së ortakëve të krijojë në Shqipëri apo jashtë vendit filiale, përfaqësi apo degë të tje-
ra mbështetur në kritere të miratuara nga organet përkatëse si dhe të legjislacionit të vendit ku ato hapen.

Neni 4

KOHEZGJATJA

Kohezgjatja e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "KORSEL" shpk është mbi 10 vjet. Ajo mund të shpërndalet përpara këtij afati me vendim unanim të Asamblesë së Ortakëve ose kur verifikohen rrethana të tilla kur shpërndarja e saj urdherohet në mënyrë të prerë nga ligji.

KREU II

KAPITALI THEMELTAR DHE KUOTAT

Neni 5

Kapitali themeltar i shoqërisë "KORSEL" shpk është 100.000 leke, kuotat e të cilit janë të ndara në këtë mënyrë :

1. Ioanit Kuniotit zoteron 80 % të kapitalit fillestar
2. Maksi Fejzulla zoteron 20 % të kapitalit fillestar

Kapitali fillestar mund t'i kthehet ortakëve vetëm në castin e likuidimit të shoqërisë apo në castin e tërheqjes së kuotës së ortakut duke mbajtur parasysh ecurinë dhe rezultatet e aktivitetit, sikurse përcaktohet në statut dhe në kontratën e themelimit.

Me vendim unanim të Asamblesë së jashtëzakonshme të ortakëve kapitali bazë mund të rritet me marrëveshje të mëvonshme nga ana e ortakëve, në mënyrë proporcionale me kuotat e pjesëmarrjes së ortakëve që marrin pjesë në krijimin e kapitalit bazë me kuotat e tyre që përcaktohen në kontratë. Mënyrat dhe afatet e derdhjes së kuotave të kapitalit përcaktohen në kontratë.

Abel 31

[Signature]

Kapitali shoqëror mbyllet me 31 dhjetor të çdo viti dhe bilanci duhet aprovuar brenda 4 muajve të ardhshëm.

Neni 6

Pjesët respektive të kapitalit themelor janë nënshkruar e shlyer tërësisht nga ortakët duke u depozituar në Banke, sipas vërtetimit që i bashkohet këtyre akteve.

Në asnjë rast kontributet në kapitalin themelor të shoqërisë nuk mund të përfaqësohen në letra me vlerë të tregtueshme apo shërbime.

Neni 7

Kuotat ose pjesët janë nominative dhe lirisht të transferueshme midis ortakëve. Transferimi i tyre bëhet vetëm me akt notarial e çdo transferim i tyre tek të tretët i nënshtrohet të drejtës së parablerjes nga ortakët. Kuotat e pjesëmarrjes në kapital janë të gjitha të emetuara e të pandarshme. Çdo kuotë i takon e drejta e një vote.

Neni 8

Nëse do të lind nevojë për vlerësimin e kuotave të ortakët caktojnë ekspert. Kur një gjë e tillë nuk arrihet me marrëveshje midis tyre, me kërkesën e njërit prej tyre, caktoni i ekspertit bëhet me vendim të Gjykatës së Rrethit Tiranë.

Ndryshimet në kapitalin themelor të shoqërisë bëhen vetëm me vendim unanim të ortakëve në Asamblenë e Ortakëve.

KREU III

ORGANET E SHOQËRISË, ASAMBLEJA E ORTAKËVE

Neni 9

Asambleja e Ortakëve është organi më i lartë i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "KORSEL" shpk. vendimet e saj në përputhje me ligjin dhe normat e këtij statuti janë të detyrueshme për të gjithë ortakët, duke përjashtuar të drejtën e tyre të ankimit kundër veprimeve që ata i çmojnë të dëmshme për interesat e tyre.

Neni 10

Organi vendimor i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "KORSEL" shpk është Asambleja e Ortakëve. Asambleja e Ortakëve zgjedh Këshillin Administrativ. Këshilli Administrativ zgjedh administratorët që do të përfaqësojnë në marrëdhënie me të tretët. Administrator do të jetë z. Maksi Fejzulla. Asambleja mbledhet në mbledhjet e saj të zakonshme

e te jashtezakonshme.

Ne mbledhjet e zakonshme ajo shqyrton e vendos per ceshtje te tilla si emerim apo shkarkim te administratorit, eksperte dhe kontabilist te autorizuar dhe likuiduesve, miratimin e raporteve, ndryshim selie, objekti, emertimi etj.

Ne mbledhjet e saj te jashtezakonshme Asambleja e Ortakeve vendos per ceshtje te tilla si ndryshimet e statutit, zvogelimin e kapitalit themeltar tek te tretet, zgjatja e kohes se veprimtarise se shoqerise apo likuidimi i saj.

Neni 11

Shoqeria merr persiper te drejta e detyrimet. Ajo pergjigjet vete per detyrimet e saj kontraktore e jashtekontraktore brenda kapitalit te saj. Ortaket bartin rrezikun per veprimtarine e shoqerise ne nivelin e shumes se mjeteve te kapitalit te investuar ne rastin e krijimit te shoqerise.

Neni 12

Shoqeria drejtohet nga nje ose disa administratorë qe duhet te jene persona fizikë dhe mund te jene ortak ne shoqeri ose jo. Ata kane mundesi te kryejne te gjitha aktet qe konsiderojne te nevojshme per arritjen e qellimeve te shoqerise, ata kane te drejta midis te tjerave te blejne e te kembejne pasuri, te lidhen me shoqeri te tjera te ngritura ose qe do te krijohen si brenda ashtu dhe jashte shtetit., duke siguruar pjesemarrje per qellimet e veprimtarise ekonomike. Emerimi i nje administratori behet per nje kohezgjatje prej tre vjetesh financiare, me perjashtim te rasteve te doreheqjes ose shkarkimit te parakohshem. Ne marredhenie me ortaket ose me te tretet administratorët kane te gjitha kompetencat per te kryer te gjitha veprimet e administrimit te shoqerise e ene emer te saj. Administratorët jane pergjegjes ndaj shoqerise ose ndaj te treteve, qofte per shkelje ligjore, qofte per shkelje te statutit, ose per fajet e kryera gjate administrimit.

Neni 13

Veprimet ekonomike e financiare te shoqerise mbyllen me 31 dhjetor te cdo viti pervec rasteve e urdherave te veçanta nga mbledhja e Asamblese se Ortakeve. Ne fund te cdo periudhe ushtri

SHOQERIA E SHQIPËRIE
miratohet brenda dates 31 mars të vitit pasardhës, dhe pas
pagimit të detyrimeve fiskale pjesa që mbetet i jepet për përdorim
Ortakut të vetëm të saj.

Neni 14

Pasuria e shoqërisë është lirisht e trashëgueshme në rrugë
trashëgimie.

Neni 15

Shpërberja e shoqërisë mund të vijë në çdo kohë dhe për çfarëdo
shkakut. Në rast mbylljeje asambleja e Ortakëve vendos mbi menyrat e
likuidimit dhe cakton një ose më shumë likuidatore duke iu përcaktuar
edhe detyrat.

Në rastin e likuidimit emërtimi i shoqërisë do të shoqërohet
nga shenimi "SHOQËRI NË LIKUIDIM E SIPER". Mbas bëhet njoftimi i mbyll-
jes së likuidimit dhe kryhen formalitetet e duhura shoqëria qërgjigjetohe-
nga Regjistri tregtar i asaj gjykate.

Neni 16

Për sa nuk është shprehur plotësisht në këtë statut i referohet
plotësimet të bëra nga Asambleja e Ortakëve.

O R T A K E T

MAKSI FEJZULLA

IOANIT KUMIOTIT

REPUBLIKA E SHQIPËRIE

NOTERIA

NR. 2663 Rep.

V E R T E T I M

Sot, me datë 23.2 1996 une noterja vertetoj se u paraqiten
ortaket e shoqërisë Maksi Fejzulla dhe Ioanit Kumiotit për identitetin
e të cilëve u sigurova nga letërnjoftimet përkatëse, madhor, me zotësi të
plate për të vepruar, të cilët deklaruan se aktet e mesipërme janë bërë
me vullnetin e tyre të lirë dhe plate dhe nënshkruan para meje noteres
dhe une e vertetoj sipas ligjit.

